



REZIDENCA STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1 SH.A.

Nr. 846 Prot.

Datë: 25/04/2022

VENDIM

I ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME TË SHOQËRISË AKSIONERE

REZIDENCA STUDENTORE UNIVERSITARE NR. 1 SH.A.

Nr. 4, datë 25 / 04 /2022

Mbështetur në ligjin 9901, datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe Shoqëritë tregtare”, Vendimin e Këshillit të ministrave Nr.335, date 04.05.2016, “Për transferimin e 100% të aksioneve të Shoqërive Aksionere “Rezidenca Studentore Universitare Nr.1” sh.a Tiranë, “Trajtimi i Studentëve Nr.2” Sh.a Tiranë, dhe “Trajtimi i Studentëve Nr.3 Sh.a Tiranë, nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes te Bashkia Tiranë”. Statuti i Shoqërisë “Rezidenca studentore Universitare Nr.1” Sh.a.

Sot, më datë 25 / 04 /2022, në ambjentet Bashkia Tiranë, u mbajt mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme, për të diskutuar dhe vendosur mbi rendin e ditës, si më poshtë vijon:

1. Njohjen, miratimin dhe depozitimin e Pasqyrave Financiare të Konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2021, të përgatitura sipas Standarteve të Raportimit Financiar.
2. Njohjen, miratimin dhe depozitimin e Raportit të Auditimit mbi Pasqyrat Financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31.12.2021, të audituara nga GMK Auditing sh.p.k me numër identifikimi Nipt L91404021H.
3. Njohjen, miratimin dhe depozitimin e Raportit mbi zvogëlimin e kapitalit të hartuar nga GMK Auditing sh.p.k me numër identifikimi Nipt L91404021H.

DUKE QENË SE:

1. Aksioneri i vetëm i Shoqërisë është Bashkia Tiranë, zotëruese e aksioneve në masën 100% të kapitalit të Shoqërisë, është paraqitur kryetari i saj Z. Erjon Veliaj duke krijuar kuorumin e nevojshëm për mbajtjen dhe vendosjen në këtë mbledhje;

- 2.Në përputhje me Statutin e Shoqërisë, Asambleja e Përgjithshme e Aksionerëve ka kompetencë të miratojë pasqyrat financiare vjetore dhe të raporteve të ecursisë së veprimtarisë.
- 3.Asambleja e Përgjithshme mbahet dhe vendos në lidhje me çështjet në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe Aktet e themelimit të Shoqërisë;
- 4.Nënshkruesi në emër të Aksionerit ka autorizimin dhe kompetencën e nevojshme për të nënshkruar dhe ekzekutuar këtë Vendim me shkrim.
- 5.Proçesverbali i mbledhjes mbahet nga Drejtori i Përgjithshëm i Shoqërisë Znj. Anila Shehu me Kryetar Z. Erion Veliaj.

Proçedohet me diskutimin e pikave të rendit të ditës si më poshtë:

Proçedohet me diskutimin e pikës së parë të rendit të ditës:

Për pikën e parë të rendit të ditës.

1. Asambleja është njohur me Pasqyrat Financiare të Konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2021, të përgatitura në bazë të Standarteve të Raportimit Financiar.

Mbledhja vazhdoi diskutimet duke shqyrtuar pikën e dytë të rendit të ditës:

- 2 Asambleja është njohur me Raportin e Auditimit mbi Pasqyrat Financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2021, të audituara nga GMK Auditing sh.p.k me numër identifikimi Nipt L91404021H.

Mbledhja vazhdoi diskutimet duke shqyrtuar pikën e tretë të rendit të ditës:

- 3 Asambleja është njohur me raportin e zvogëlimit të kapitalit të hartuar nga GMK Auditing sh.p.k me numër identifikimi Nipt L91404021H.

Për këto arsye, pas diskutimit të rendit të ditës dhe duke mos patur pika të tjera për të diskutuar dhe vendosur, Aksioneri i Vetëm i Shoqërisë

VENDOSI:

1. Njohjen, miratimin dhe depozitimin e Pasqyrave Financiare të Konsoliduara për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2021, të përgatitura sipas Standarteve të Raportimit Financiar.
2. Njohjen, miratimin dhe depozitimin e raportit të Auditimit mbi Pasqyrat Financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2021, të audituara nga GMK Auditing sh.p.k me numër identifikimi Nipt L91404021H.
3. Njohjen, miratimin e humbjes së krijuar nga aktiviteti i shoqërisë për vitin 2021 në shumën 95,916,150 lekë, e cila të mbartet në vitin ushtrimor që mbyllet më 31 dhjetor 2022.
4. Njohjen, miratimin dhe depozitimin e raportit të zvogëlimit të kapitalit të hartuar nga GMK Auditing sh.p.k me numër identifikimi Nipt L91404021H.

5. Të zbatohen rekomandimet e lëna në raport nga Audituesit Ligjor.
6. Të autorizojë Drejtorin e Përgjithshëm të Shoqërisë, të ekzekutojë dhe të dorëzojë në emër të shoqërisë, çdo dokument të nevojshëm për të zbatuar këtë vendim duke përfshirë, por pa u kufizuar në Qendër Kombëtare të Biznesit dhe/ose para çdo autoriteti tjetër kompetent, siç kërkohet nga legjislacioni i zbatueshëm shqiptar.

AKSIONARI I VETËM

BASHKIA TIRANË

Erion Veliaj
Kryetar

